



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Member of International Helsinki Federation for Human Rights*

RAPORTI I DREJTAVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI 2007 **Raport i Komitetit Shqiptar të Helsinkit**

Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH-ja) është organizata e parë joqeveritare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri e krijuar në vitin 1990. Misioni kryesor i KShH-së është vëzhgimi i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, rivendosja e të drejtave të shkelura, ndërgjegjësimi i shtetasve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre, përmirësimi i legjislacionit dhe i praktikës për zbatimin e ligjit.

Ky raport trajton gjendjen e të drejtave të njeriut në fushat ku KShH-ja ka punuar gjatë vitit 2007, zhvillimet me të rëndësishme të ndodhura në vitin 2007; reformat ligjore dhe institucionale, probleme të infrastrukturës dhe logjistikës të cilat në këtë ose në atë mënyrë kanë ndikuar në respektimin e të drejtave të njeriut; problemet e konstatuara gjatë vëzhgimeve ose kontakteve të KShH-së me qytetarë, persona të arrestuar dhe të dënuar, përfaqësues të minoriteteve etj.

Shteti i së drejtës dhe përpjekjet për integrim në Bashkimin Europian and NATO

Gjatë vitit 2007, Qeveria Shqiptare bëri përpjekje për të përmbushur standartet për të hyrë në strukturat euroatlantike. Gjatë vitit 2007, vazhdoi procesi i ratifikimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit nga parlamentet e vendeve anëtare të Bashkimit Europian. Në kuadër të integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian u realizua procesi i rishikimit të Planit Kombëtar të Zbatimit të MSA dhe u miratua Plani Kombëtar i Zbatimit të MSA për vitet 2007-2012.

Krahas zhvillimeve ekonomike, qeveria shqiptare duhet të përmbushë edhe kriteret politike të Kopenhagenit, pjesë e të cilave janë: përfundimi i reformës zgjedhore, infrastruktura dhe administrimi i zgjedhjeve, reformimi i sistemit të gjendjes civile, pajisja e qytetarëve shqiptarë me dokumente identiteti me nivel të lartë sigurie, reformimi i sistemit të drejtësisë, decentralizimi, reforma në administratën publike, lufta kundër krimit dhe korrupsionit.

Gjatë vitit 2007, reforma zgjedhore dhe ajo në sistemin e drejtësisë konsistoi vetëm në ngritjen e komisioneve parlamentare që do të punonin në fushat përkatëse, pa shënuar progres të mëtjeshëm. Klasa politike shqiptare nuk tregoi maturinë politike në zgjedhjet vendore të 18 shkurtit 2007 si dhe zgjedhjet e Presidentit të Republikës në korrik të vitit 2007. Mungesa e bashkëpunimit konstruktiv dhe e vullnetit politik për bashkëpunim mes pozitës dhe opozitës solli një vit me debate dhe konflikte politike mes forcave politike. Ndonëse zgjedhja e Presidentit të Republikës u krye brenda kuadrit kushtetues, mënyra se si u procedua nuk krijoi besueshmërinë e kërkuar të palëve gjë e cila reflektoi në debate kundërshtuese mbas kësaj zgjedhjeje.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Member of International Helsinki Federation for Human Rights*

Viti 2007, u shoqërua me debate të shumta dhe akuza të ndërsjella, sidomos dy partive më të mëdha, Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste. Disa seanca parlamentare u pezulluan dhe nuk u zhvilluan në kushte normale për shkak të tensioneve politike. Këto tensione shkaktuan vonesa në realizimin e reformave në fusha të rëndësishme të vendit. Kuvendi i Shqipërisë ngriti një komision të ri hetimor parlamentar për të hetuar Prokurorin e Përgjithshëm. Komisioni brenda një kohe të shkurtër mori vendimin për t'i propozuar Presidentit të Republikës shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Presidenti i Republikës dekretoi shkarkimin e tij.

Zgjedhjet

Ndonëse kaluan 18 muaj nga zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut 2005 komisioni parlamentar për ndryshimet në Kodin Zgjedhor për shkak të mosmarrëveshjeve partiake dhe të mungesës së konsensusit midis forcave politike nuk funksionoi, Asnjë nga rekomandimet e OSBE/ODIHR-it dhe të organizatave vëzhguese vendase nuk u shqyrtuan. Forcat politike arritën vetëm një marrëveshje për të ndryshuar dy nene të Kushtetutës që kishin të bënin me faktin që zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të zhvilloheshin një herë në katër vjet, ndërsa përbërja e KQZ-së të rritej nga 7 në 9 anëtarë. U vendos gjithashtu që komisionet e tjera zgjedhore të përbëheshin me 13 anëtarë, nga 7 që ishin më parë.

U debatua gjatë dhe ashpër midis partive, sidomos midis dy partive më të mëdha, për shtyrjen e datës së zgjedhjeve nga muaji janar në muajin shkurt 2007 dhe më së fundi u arrit marrëveshja. Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore u caktuan në 18 shkurt 2007. Duke filluar nga tre mujori i fundit i vitit 2006 dhe janari i vitit 2007 objekt diskutimi u bë çështja e heqjes nga Kodi Zgjedhor të dispozitave që kishin të bënin me të drejtën e votimit të zgjedhësve me banim të përkohshëm. Pas shumë debate e diskutime, u arrit marrëveshja, gjë që u pasqyrua edhe në ligj.

Një problem tjetër serioz ishte edhe ai i pajisjes së shtetasve me çertifikata identiteti të vlefshme për votime. Edhe për këtë çështje, me shumë vonesë, pikërisht në muajin Janar 2007 u arrit marrëveshja. Vlen të përmendet se ndryshimet në Kodin Zgjedhor, përfshirë edhe atë të çertifikatave të lëshuara nga zyrat e gjendja civile u bënë vetëm në muajin Janar 2007, pra disa dita para mbajtjes së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore

Pavarësisht nga disa anë pozitive që u vunë re në zgjedhjet e 18 shkurtit 2007, standardet e kërkuara nuk u arritën. Sipas përfundimeve që jepen në Raportin e OSBE/ODIHR-it këto zgjedhje ishin një shans i humbur për politikën shqiptare. Vonesat në ndryshimet e Kodit zgjedhor reflektuan në mënyrë negative në aspektet e ndryshme të procesit zgjedhor, si: veprimtarinë e KQZ-së, ngritjen me vonesë të KZQV-ve, KQV-ve dhe grupeve të numërimit të votave.

Partitë politike jo gjithnjë respektuan Kodi i etikës, ndërsa propaganda zgjedhore në disa raste u shoqërua me gjuhën e urrejtjes, gjë që ndikoi edhe në veprimtarinë e komisioneve



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Member of International Helsinki Federation for Human Rights*

zgjedhore. KShH-ja në bashkëpunimin me disa organizata të tjera të shoqërisë civile¹ i bënë thirrje kandidatëve për të respektuar Kodin e Etikës. Në janar 2007, KShH-ja mes një deklarate publike u bëri thirrje partive politike dhe kandidatëve të tyre për të dhënë fund gjuhës së urrejtjes në fushatat elektorale.

Në komisionet e zgjedhjeve dhe sidomos në grupet e numërimit të votave, në mjaft raste ra në sy njëanshmëria, mbrojtja e interesave të ngushta partiake, politizimi në dëm të zbatimit rigoroz të ligjit, konfliktualiteti midis anëtarëve të propozuar nga partitë e pozitës dhe të opozitës. Atmosfera konfliktuale në disa raste çoi në ndërprerjen ose bllokimin e procesit të numërimit të votave. Gjatë vitit 2007 u zhvilluan dy zgjedhje të pjesshme parlamentare. Gjatë monitorimit të tyre edhe organizatat vëzhguese vendase vërejtjen të meta serioze.

Në raportin e OSBE/ODIHR-it lidhur me zgjedhjet e 18 shkurtit 2007 u paraqitën mjaft rekomandime që do t'i shërbenin një reforme më të plotë zgjedhore. Për këtë do të duhej të ngrihej një Komision i Posaçëm Parlamentar. Nisma e ndërmarrë për krijimin dhe funksionimin e këtij komisioni u ndërpre për shkak të konflikteve partiake lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës. Mbas zgjedhjes së Presidentit të Republikës, mandati i komisionit parlamentar të reformës zgjedhore u shty për dy herë rresht. Ky komision, veç ndonjë diskutimi, nuk bëri asgjë konkrete. Kjo ishte arsyeja që Kuvendi i Shqipërisë edhe një herë tjetër vendosi shtyrjen e mandatit të Komisionit për reformën zgjedhore. Viti 2007 u mbyll pa asnjë rezultat konkret nga puna e Komisionit të reformës zgjedhore. Problemet që duhen zgjidhur janë të shumta, por më të rëndësishme konsiderohen pajisja e shtetasve me karta identiteti, krijimi i regjistrit themeltar të shtetasve i kompjuterizuar, duke patur parasysh edhe sistemin e adresave.

Parlamenti i Shqipërisë duhej të zgjidhte çështje të tilla si: sistemi zgjedhor dhe nëse komisionet zgjedhore duhet të propozohen nga partitë politike ose ato duhet të përbëhen nga profesionistë - teknokratë.

Gjatë vitit 2007 disa organizata jo-fitimprurëse me përvojë në fushën e monitorimit të zgjedhjeve diskutuan gjerësisht lidhur me ndryshimet që duhet të pësojë Kodi Zgjedhor dhe kanë bërë rekomandimet përkatëse. Megjithë propozimet e tyre, në prill 2008 Kuvendi i Shqipërisë kaloi brenda një kohë shumë të shkurtër disa ndryshime të rëndësishme kushtetuese, pjesë e të cila është edhe sistemi zgjedhor.

Respektimi i të drejtave të shtetasve nga policia

Respektimi i të drejtave të njeriut nga ana e policisë vazhdoi të jetë në vëmendje të KShH-së. Në fillim të vitit 2007, u dekretua ligji i ri "Për policinë e shtetit". Një pjesë e vërejtjeve dhe sugjerimeve të bëra për projekt ligjin nga Avokati i Popullit, KShH-ja dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile u morën parasysh në variantin përfundimtar të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

¹ Qendra për Studimet Parlamentare, Fondacioni i Shoqërisë së Hapur (SOROS), Shoqata për Kulturë Demokratike, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, Koalicioni për Nxitjen e Pjesëmarrjes së Grave, të Rinjve dhe Minoriteteve në Politikë, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Forumi i mendimit të lirë, Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Member of International Helsinki Federation for Human Rights

Edhe gjatë vitit 2007, KShH-ja vazhdoi të marrë ankesa nga qytetarë ose persona të ndaluar apo të arrestuar që pretendonin për shkelje të të drejtave të tyre nga ana e punonjësve të policisë. Nga verifikimet e bëra nga KShH-ja, ka rezultuar se në disa raste të dhënat e personave të ndaluar në komisariate nuk mbahen në mënyrë të rregullt dhe për rrjedhojë ishte e vështirë të kontaktohej me ta dhe të verifikoheshin pretendimet e tyre në vazhdimësi, sidomos pas lirimit të tyre nga dhomat e ndalimit ose të shoqërimit.

Qytetarët u ankuan për keqtrajtime dhe ushtrim dhune nga ana e policisë, por pak raste u denoncuan prej tyre në organet e prokurorisë. Verifikimi i këtyre rasteve ka qenë i vështirë për shkak të mungesës së denoncimeve në kohën e duhur në prokurori. Veç kësaj, personat nuk janë parë nga mjeku ligjor. Në rastin e të miturit E. D, nga verifikimet e kryera nga KShH-ja rezultoi se pas ushtrimit të dhunës nga policia, i mituri nuk është dërguar në spital për të marrë ndihmën e nevojshme mjekësore. Ankuesit pretendojnë se dhuna ushtrohet gjatë momentit të ndalimit, mbajtjes në dhomat e shoqërimit, përpara vlerësimit të masës së sigurisë nga gjykata ose gjatë transportimit për në komisaratin përkatës. KShH-ja ka kërkuar marrjen e masave për parandalimin e rasteve të përdorimit të dhunës dhe kryerjen e hetimeve të shpejta, të gjithanshme dhe objektive.

Ankesat e personave të ndaluar dhe të arrestuar në flagrancë kanë konsistuar edhe në drejtim të pengimeve që kanë hasur për takimin e shpejtë me mbrojtësit e tyre gjë që bien ndesh me dispozitat kushtetuese dhe të Kodit të Procedurës penale.

Respektimi i të drejtave të shtetasve në sistemit e drejtësisë penale

Megjithëse sistemi gjyqësor dhe reforma në drejtësi është një nga prioritetet e reformës për t'u anëtarësuar në BE, reforma në drejtësi eci me ritme relativisht të ngadalta. Gjatë vitit 2007, shtetas të ndryshëm, persona të paraburgosur dhe të dënuar, ose familjarë të tyre janë ankuar pranë KShH-së për shkelje të të drejtave të tyre në proceset gjyqësore.

Qytetarët ankohen për mungesë të marrjes **së informacionit** në gjykatat e niveleve të ndryshme, sidomos lidhur me kërkesat e tyre për rishikim të çështjes. Shqetësimi më i madh paraqitet nga persona që janë duke vuajtur dënimin në institucionet e ekzekutimit të dënimeve me burgim dhe shtetas që nuk kanë kulturë juridike të mjaftueshme lidhur me ankimin e vendimeve dhe procedurën e ankimit. Pakënaqësi ka patur edhe në rastet kur personat e dënuar ishin mbrojtur nga avokatë të caktuar kryesisht. Në një studim të Misionit të OSBE-së të botuar në vitin 2007, lidhur me funksionimin e gjykatave të Apelit, rezultoi se rregullat procedurale që normojnë ankimin shpesh herë nuk respektohen².

Persona të akuzuar për vepra penale nga drejtësia shqiptare pretendojnë **për vendime gjyqësore të padrejta**. Nga kontaktet me ta shihet se një pjesë e tyre nuk kanë njohuritë e mjaftueshme ligjore lidhur me procedurat e hetimit dhe gjykimit dhe nuk janë mbrojtur nga avokatë profesionistë. Mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare, jo në pak raste ka sjellë pretendime të shtetasve për një proces gjyqësor jo të rregullt dhe kanë marrë një shërbim ligjor jo profesional prej avokatëve të tyre.

² Referuar Raportit të OSBE-së "Analizat e ankimeve penale në Shqipëri", viti 2007, f. 3.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Member of International Helsinki Federation for Human Rights*

Zvarritjet e proceseve gjyqësore vazhdojnë të mbetet një problem shqetësues. Nga verifikimet e kryera nga KShH-ja ka rezultuar se shkaqet e zvarritjeve janë të ndryshme si: mungesa e avokatit mbrojtës në seancë, i pandehuri nuk dërgohet nga institucioni i paraburgimit në seancë gjyqësore; në gjykimin e shtetasve të huaj vihet re mungesa e letërporosive nga shtetet e tjera, sidomos Maqedonia, mosardhja e dëshmitarë në seancat gjyqësore, shtyrje të pamotivuara nga vetë gjyqtarët, etj. Zvarritjet e proceseve gjyqësore në disa raste tejkalojnë afatet maksimale të paraburgimit të përcaktuara në Kodin e procedurës penale, duke çuar në pezullimin e afateve të paraburgimit.

Në çështjen e shtetasve M.M dhe disa të pandehur të tjerë, e cila gjykohej në Gjykatën e Krimeve të Rënda, Tiranë, nga verifikimet e kryera në databasin elektronik të kësaj gjykate ka rezultuar se në mënyrë të vazhdueshme ka patur mungesa të avokatëve të të pandehurve të ndryshëm. Kjo ka sjellë jo vetëm shtyrje të procesit gjyqësor, por njëkohësisht dhe pezullimin e afateve të paraburgimit të të pandehurve të tjerë, avokatët e të cilëve kanë qënë të pranishëm.

Bazuar në ankesat që i janë dërguar KShH, në qershor të vitit 2007 KShH i është drejtuar Dhomës Kombëtare të Avokatisë me rekomandimin për marrjen e masave për avokatët mbrojtës që kanë shkaktuar shtyrje të proceseve gjyqësore. Veç kësaj, në korrik 2007 i dërgoi një letër Ministrisë së Drejtësisë ku evidentoi faktin e vonesave në procedurat për letërporositë nga shtetet e huaja. Deri më sot, nuk jemi vënë në dijeni për masat e mara nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve për parandalimin e zvarritjeve të seancave gjyqësore. Ministria e Drejtësisë ka reaguar ndaj kësaj çështje me anë të një letre drejtuar KShH në prill të vitit 2008.

Sipas ligjit shqiptar, shërbimi i avokatisë është i pavaruar dhe privat. Qytetarë të ndryshëm janë ankuar për avokatët e zgjedhur nga ana e tyre dhe avokatët e caktuar nga shteti në çështjet penale. Persona të arrestuar dhe të dënuar të kontaktuar nga përfaqësues të KShH-së kanë pretenduar për procese të parregullta ligjore ndaj tyre dhe e shohin shpëtimin te Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. KShH lidhur me pretendimet për proces jo të rregullt ligjor u ka bërë të qartë ankuesve se ata mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

KShH-ja vlerëson faktin që shtetasit shqiptarë po ndërgjegjesohen për rolin e GJEDNJ në mbrojtje të të drejtave të tyre kushtetuese, por ndërkohë shpreh shqetësimin se shumë prej tyre nuk kanë kulturën e duhur lidhur me faktin se para se të kërkojnë të vënë në lëvizje GJEDNJ, ata duhet të kenë shteruar mjetet e brendshme dhe se ata nuk besojnë te gjykatat shqiptare.

Aksesi në drejtësi është një e drejtë që njihet nga legjislacioni shqiptar. Ligji njeh të drejtën që personat që nuk kanë mjetet e nevojshme financiare të përfitojnë shërbim ligjor falas dhe shpenzimet paguhet nga shteti. Shërbimi ligjor falas vazhdon të ketë probleme sidomos për shqyrtimin e kërkesave për rishikim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë pranë Gjykatës së Lartë. Legjislacioni ynë penal ka një vakum ligjor pasi mundësia për të patur një avokat falas të siguar nga shteti njihet vetëm në shkallën e parë dhe të dytë të gjykimit dhe jo në gjykimin në Gjykatën e Lartë. Ndjekja e gjykimit në Gjykatën e Lartë bëhet gati e pamundur për atë kategori të dënuarish që nuk kanë mundësi financiare



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Member of International Helsinki Federation for Human Rights*

për të siguruar një avokat privat si dhe duke marrë parasysh që në Shqipëri nuk ka asnjë klinikë ligjore që të ofrojë një shërbim të tillë. Pavarësisht nga kërkesat e përsëritura, institucionet përgjegjëse shtetërore nuk kanë marrë ende masat konkrete për rregullimin më të saktë ligjor të këtij problemi. Komiteti Shqiptar i Helsinkit e ka ngritur këtë çështje në vëmendje të autoriteteve përkatëse shtetërore disa herë, por problemi deri më sot nuk ka gjetur zgjidhje.

Gjatë vitit 2007, TLAS, një organizatë jofitimpruruese që ofron shërbime për njerëzit në nevojë ndërmori iniciativën për hartimin e projektligjit “Për shërbimin ligjor falas”. Në dhjetor të 2007, u zhvillua një tryezë me pjesëmarrjen e organizatave që ofrojnë shërbime, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe ekspertë në fushë. Deri në fund të vitit 2007, projekti nuk u bë objekt diskutimi në procedurat parlamentare.

Trajtimi i personave të mitur dhe të dënuarve të sëmurë, me sëmundje fizike ose psikike vazhdon të përballet me shkelje të rënda të të drejtave që njeh ligji njeh për ta. Ndonëse Kodi penal parashikon mundësitë e zbatimit të masave mjekësore dhe detyron gjykatat të rishikojnë vendimet e dhëna. Nga vëzhgimet e bëra në Spitalin e Burgut në muajin nëntor 2007 u gjendën 72 persona për të cilët gjykatat e rretheve gjyqësore përkatëse kanë dhënë dënime me masë mjekësore. Pavarësisht se kishte kaluar më shumë se një vit nga dhënia e këtyre vendimeve, ato nuk ishin rivlerësuar nga gjykatat përkatëse.

Mosekzekutimi i vendimeve civile të formës së prerë nga ana e shërbimit përmbartimor vazhdon të mbetet një problem shqetësues. KShH shpesh herë ka adresuar shqetësimet e shtetasve që janë ankuar pranë saj në organet drejtuese të këtyre zyrave, duke kërkuar zbatimin e dispozitave ligjore. Në disa raste, zyra e shërbimit përmbartimor është përgjigjur se vendimet nuk ekzekutohen pasi personi nuk ka pasuri ose të ardhura, duke cënuar në këtë mënyrë të drejtat e shtetasve që kanë fituar të drejtat e tyre me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Respektimi i të drejtave të personave të paraburgosur dhe të dënuar

Gjatë vitit 2007, reforma ligjore në fushën e paraburgimit dhe në burgje u përqëndrua në përmirësimin e legjislacionit lidhur me masat alternative dhe shërbimin e provës, në ndryshimet e ligjeve të tilla si: ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, ligji “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, dhe në hartimin ose përmirësimin e disa akteve nënligjore si: Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve dhe VKM “Për zhvillimin e aktivitetit të punës në institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale dhe kriteret e shpërblimit të saj”. Përveç Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve e cila ka hyrë në fuqi të gjitha propozimet për ndryshime në Kodin Penal, ligjet dhe vendimet e sipërpërmendura nuk kaluan për miratim në Kuvend deri në fund të vitit 2007.

Ministria e Drejtësisë kërkoi mendimin e aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile dhe organizmave ndërkombëtare lidhur me projektligjet. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Misioni Euralius ofruan mendimet e tyre ligjore lidhur me pothuajse të gjitha projektligjet e sipërcituara.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Member of International Helsinki Federation for Human Rights*

Për më shumë se një vit vazhdoi debati lidhur me miratimin projekt-ligjit "Mbi disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 8678, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë" si edhe ligji "Për organizimin dhe funksionin e pushtetit gjyqësor në RSH". KShH-ja ofroi opinionin e tij duke synuar që ndryshimet të mos çënojnë pavarësinë e gjyqësorit, por përkundrazi ta forcojnë atë.

KShH-ja vlerëson kalimin në fakt të sistemit të paraburgimit në varësinë të Ministrisë së Drejtësisë. KShH-ja është e ndërgjegjshme që ky proces përbën një sfidë për administratën e burgjeve. Gjatë viteve në vazhdim kërkohet vëmendje maksimale e të gjithë autoriteteve të larta përgjegjëse për administrimin e këtyre institucioneve.

Gjatë vitit 2007 vazhdoi ndërtimi ose rikonstruksioni i disa burgjeve dhe institucioneve të paraburgimit si: burgu i Fushë-Krujës, Korçës, Durrësit, Kavajës dhe paraburgimi i Vlorës. Burgu i Fushë Krujës pritej të merrej në dorëzim nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, por nuk u bë i mundur. Nga takimet me autoritet përkatëse mësohet se këto projekte do të përfundojnë gjatë vitit 2008. Investime të tjera janë realizuar edhe në disa paraburgime dhe burgje ekzistues si: Lezhë, Vaqarr, institucioni e paraburgimit "Jordan Misja", Berat, Elbasan, etj.

Problem shqetësues në të gjitha burgjet dhe institucionet e paraburgimeve të vëzhguara mbetet mbipopullimi, numri i konsiderueshëm i personave të privuar nga liria që vuajnë me probleme psikike të cilët mbahen në burgje dhe paraburgime të ndryshme dhe një pjesë në Qendrën Spitalore të Burgjeve. KShH-ja e ka ngritur këtë shqetësim edhe më parë. Megjithatë, institucioni për trajtimin e këtyre personave i planifikuar për t'u ndërtuar në Durrës ende nuk ka përfunduar.

Në pjesën më të madhe, institucionet e paraburgimeve që vazhdojnë të jenë në ndërtesat e komisariateve të policisë kanë një infrastrukturë tejet të amortizuar. Gjendja e disa prej tyre është mjaft e keqe. Më datë 15 nëntor 2007, me anë të një deklarate për shtyp, KShH-ja ka sensibilizuar autoritetet përkatëse shtetërore dhe gjithë opinionin publik për problemet në institucionin e paraburgimit Vlorë dhe me anë të një shkresë zyrtare drejtuar Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë ka ngritur shqetësimin për gjendjen në vendet e tjera të paraburgimit.

Kalimi i institucioneve të paraburgimit në administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u shoqërua me përzgjedhje të personelit të ri. Gjatë vitit 2007, u punësua me kohë të plotë psikologë në të gjitha burgjet dhe paraburgimet që ndodhen parnë institucioneve të ekzekutimit të dënimit me burgim. Edhe pas disa muajsh të këtij kalimi, disa pozicione si: mjek dhe infermier kanë mbetur të paplotësuara Mungesa e mjekut në disa institucione paraburgimi është një shqetësim serioz dhe çënon rëndë të drejtën për përfitimin e shërbimit shëndetësor nga ana e personave të paraburgosur. Në disa institucione të paraburgimit kishte mungesë totale të medikamenteve mjekësore. Në pjesën më të madhe të rasteve këto medikamente siguroheshin nga familjarët.

Zbatimi i masave alternative nga gjykatat mbetet ende në nivele të ulta. Megjithatë disa hapa pozitive u ndërmorën gjatë vitit 2007 si: diskutimi i projektligjit për alternativat e dënimit me burgim, trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe sensibilizimin e publikut



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Member of International Helsinki Federation for Human Rights*

për efektivitetin e përdorimit të tyre mbështetur kryesisht nga UNICEF, SIDA, EU dhe OSBE.

Pati të paraburgosur të intervistuar të cilët pretenduan se nuk janë njohur me të drejtat e tyre në momentin e ndalimit ose arrestimit të tyre. Disa të mitur të pyetur kanë pohuar gjithashtu se nuk janë njoftuar familjarët ose kujdestarët e tyre gjë që bien ndesh me normat e Kodit të Procedurës Penale. Edhe të dënuarit kanë pretenduar për përdorim të dhunës nga punonjës me uniformë në vendet e vuajtjes së dënimit. Në disa raste, pas verifikimeve të kryera, KShH ka vënë në dijeni organin e Prokurorisë të cilët kanë kryer veprimet përkatëse. Ka vështirësi për verifikimin e ankesave të tilla. Sepse sipas disa të dhënave pas ushtrimit të dhunës, ndaj personave është marrë masa disiplinore e izolimit me argumentin se kanë cënuar rregulloren e institucionit. Mbas ndërhyrjeve të KShH-së, në mjaft raste drejtuesit e institucioneve kanë reguar duke pretenduar se përdorimi i forcës ndaj të dënuarve ka qënë i ligjshëm pasi ata kanë cënuar rregulloren e institucionit.

Gjatë vitit 2007, Komisioni Mbikëqyrës i Ekzekutimit të Vendimeve Penale me Burgim vazhdoi të mos funksiononte. KShH-ja e ka ngritur këtë çështje në vëmendjen e Ministrisë të Drejtësisë për marrjen e masave konkrete për vënien në funksion të plotë të Komisionit dhe ka ofruar rekomandime konkrete për mirëfunksionimin e tij duke e parë këtë çështje nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut dhe standardeve ndërkombëtare.

Megjithë përpjekjet që bëhen, trajtimi i të miturve dhe femrave të arrestuara dhe të dënuara nuk është në përputhje me standartet minimale të përcaktuara në dokumentat ndërkombëtare dhe të në legjislacionin shqiptar. Gjatë vitit 2007, aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile realizuan disa trajnime të stafit të edukimit që merren me trajtimin e të miturve dhe grave që vuajnë dënimin me burgim ose që janë në vendet e paraburgimit. KShH-ja realizoi një trajnim trajnerësh të 23 punonjësve socialë, psikologëve dhe edukatorëve që punojnë me të mitur dhe gra në institucionet e tyre si edhe hartoi një manual trajnimi për personelin që punon me të mitur dhe gra në sistemin penitenciar. Trajnimet kanë synuar rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit, por edhe përgatitjen e një grupi trajnerësh që do të trajnojnë më pas stafin në sektorë të tjerë të institucioneve të paraburgimeve dhe burgjeve. KShH-ja ka mundur të vëzhgojë nga afër një pjesë të realizimit të këtyre trajnimeve. Sipas informacionit të dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, këto trajnime kanë vazhduar të realizohen edhe në institucionet e tjera të vuajtjes së dënimit.

Në kuadër të programit CARDS, disa trajnime janë zhvilluar me administratën e burgjeve për fuqizimin e sektorit të trajnimit të administratës së burgjeve, përmirësimit të procedurave të përzgjedhjes në sistemin e burgjeve, të aftësive profesionale dhe drejtuese të drejtuesve të lartë të burgjeve po punohet për të përmirësuar procedurat e përzgjedhjes se personelit të ri, disa prej të cilave do të fillojnë të zbatohen me përzgjedhjen e personelit me hapjen e burgjeve të reja si ai i Fushë Krujës dhe Korçës. Gjithsesi, mbetet ende punë për të bërë në këtë drejtim të rritjes së profesionalizmit të administratës së vendeve të paraburgimit dhe të burgjeve.

Persona të arrestuar dhe të dënuar pretendojnë për mungesë të transparencës së veprimeve të administratës së burgjeve lidhur me veprime tilla si: blerjet e ushqimeve dhe



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Member of International Helsinki Federation for Human Rights*

mjeteve të tjera për të dënuarit, çmimet më të larta të tyre në krahasim me tregun, mosnjohjen e rregullores së burgjeve dhe paraburgimit të institucioneve përkatëse, etj.

Ndonëse ligji ka rregulluar mekanizmin e kërkesë- ankesës në institucionet e vuajtjes së dënimit, personat e paraburgosur dhe të dënuar u ankuan për moskthim në kohë i përgjigjeve të ankesave – kërkesave të tyre nga ana e administratës së institucionit në të cilin ata vuajnë dënimin. Ankesa të shumta janë marrë lidhur me transferimet dhe mungesën e procedurave transparente të tyre, për mosinformimin e tyre lidhur me ankesat brenda afatit ligjor. Bazuar në ankesat e tyre, KShH i është drejtuar drejtuesve të këtyre institucioneve si Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilat në disa raste kanë trajtuar këkesën e personit ose nuk kanë pranuar ekzistencën e tij. Cënimi i korrespondencës së të dënuarve nga administrata e disa burgjeve është një tjetër shqetësim i ngritur, por i pamundur për t'u verifikuar.

Të drejtat e minoriteteve

Gjatë vitit 2007, Qeveria shqiptare mori disa masa me karakter ligjor dhe institucional në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë për një respektim më të mirë të të drejtave të minoriteteve. Vëmendje i është kushtuar monitorimit të respektimit rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare si BE, KE dhe Komisionit Europian kundër Intolerancës dhe Racizmit (ECRI).

Gjatë vitit 2007 përmirësime pozitive u bënë në kodin penal duke parashikuar si rrethanë rëndësuese kryerjen e veprës penale shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale. Gjithashtu, me ndryshimet e bëra parashikohet kryerja e veprës penale të Torturës për arsye diskriminimi. Megjithëse shoqëria civile ka marrë nismën e hartimit të një ligji të posaçëm kundër diskriminimit, kjo nismë nuk është finalizuar deri më sot.

Ende nuk është realizuar amendimi i Kodit Zgjedhor për parashikimin e dispozitave pozitive që lejojnë përdorimin e gjuhës së minoriteteve gjatë fushatave elektorale në zonat ku ka një përqëndrim të minoriteteve. Në kuadër të miratimit të Rregullores për të drejtën e përdorimit të gjuhës amtare të minoriteteve në emërtimet lokale dhe treguesit e tjerë topografikë në zonat ku ato banojnë, janë nënshkruar memorandume mirëkuptimi ndërmjet prefektëve dhe kryetarëve të njësisve të qeverisjes vendore në disa rrethe të vendit si: Korçë, Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastër.

Komiteti Shtetëror i Minoriteteve zhvillon aktivitetin e tij që nga marsi i vitit 2004. Ndërkohë që ka pak informacione dhe raporte mbi punën e Komitetit në lidhje me çështjet e diskriminimit të minoriteteve.

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”, është krijuar dhe funksionon Sektori i Monitorimit të Zbatimit të Strategjisë. Gjatë vitit 2007, ky sektor e zhvilloi veprimtarinë e vet si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Trainimit, Koordinimit të Projekteve dhe Monitorimit pranë Shërbimit Social Shtetëror në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Sektori është një strukturë relativisht e dobët për shkak të mandatit që ka dhe pozicionit që zë në raport



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Member of International Helsinki Federation for Human Rights*

me institucionet e tjera të administratës shtetërore. Me mbështetje të PNUD-it u punua për të ngritur kapacitetet dhe fuqizuar sektorin e monitorimit; është punuar për të përmirësuar indikatorët e monitorimit të strategjisë, për të ngritur një bazë të dhënash (DevInfo) dhe përgatitur formati i raportimit për progresin në zbatimin e masave prioritare dhe përmbushjen e objektivave të parashikuara. Ndonëse është kërkuar forcimi i këtij sektori, gjatë vitit 2007 ai vazhdoi të ketë të njëjtin status.

Edhe për vitin 2007, vazhdoi të mos kishte të dhëna të sakta lidhur me numrin e popullatës në minoritete. Megjithë problemet që ka komuniteti rom dhe komuniteti egjiptian, sot nuk ka statistika që të evidentojnë gjendjen e frekuentimit të kopshteve nga fëmijët Romë ose egjiptianë. Hapja dhe funksionimi i kopshteve Rome ka gjetur mbështetjen e gjerë të donatorëve të huaj dhe vendas, falë bashkëpunimit që ato kanë patur me shoqatat Rome. Njësitë e qeverisjes vendore kanë marrë masa për të nxitur regjistrimin e fëmijëve Romë në institucionet e arsimit parashkollor. Përvoja pozitive janë të pranishme në disa bashki të vendit si në atë të Tiranës, por nuk ka informacion për iniciativa të kësaj natyre nga njësitë e rretheve të tjera të qeverisjes vendore.

Fushatat sensibilizuese për përfshirjen e fëmijëve Romë në arsim kanë qenë të pjesshme dhe jo gjithëpërfshirëse. Në to ka munguar koordinimi i mjeteve dhe forcave të shoqatave me ato të institucioneve arsimore. Për t'iu ardhur në ndihmë nxënësve që kanë braktisur shkollën është inicuar projekti "Shansi i dytë". Nga takimet me përfaqësues të minoriteteve dhe të institucioneve që ofrojnë arsimin rezulton se jo të gjithë fëmijët romë e përdorin këtë mundësi dhe se shumë prej fëmijëve nuk e ndjekin arsimin e plotë.

Gjatë vitit 2007, media ka rritur vëmendjen e saj ndaj çështjeve të minoritetit romë, por ka ende vend për përmirësime. Etika gazetareske ka nevojë të respektohet më shumë. Për të rritur profesionalizimin e gazetarëve dhe për të informuar lidhur me konceptet lidhur me mosdiskriminim janë zhvilluar disa trajnime nga Instituti i Medias dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit, por mbetet ende për të bërë në këtë drejtim.

Komuniteti Egjiptian në Shqipëri nuk ka patur vëmendje të veçantë nga ana e shtetit shqiptar. Megjithë rekomandimet e organizatave vendase dhe të huaja dhe gjendjen e vështirë ekonomiko-sociale, nuk është parashikuar një strategji e veçantë për këtë komunitet. Pjesëmarrja e minoritetit Rom dhe komunitetit Egjiptian në jetën publike dhe politike është e dobët. Përzgjedhja e tyre në strukturat përfaqësuese bëhet duke marrë në konsideratë kryesisht aktivizimin e tyre në parti politike, por minoriteti Rom dhe komuniteti Egjiptian nuk e sigurojnë lehtësisht një gjë të tillë. Sipas vëzhgimeve të bëra pas zgjedhjeve të fundit vendore, përqindja e pjesëmarrjes së zgjedhësve të regjistruar që u përkasin grupeve minoritare ishte i dobët, kryesisht për romët dhe egjiptianët. Nga ana tjetër, mjaft romë e egjiptianë nuk janë regjistruar në listat zgjedhore. Zbatimi i masave pozitive-favorizuese në punësimin e minoriteteve në përgjithësi nuk realizohet. Janë marrë disa masa për përfaqësimin e tyre në rradhët e policisë, por përfaqësimi i tyre lë për të dëshiruar.

Respektimi i të drejtave të shtetasve në pikat e kalimit të kufirit



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Member of International Helsinki Federation for Human Rights*

Sipas KShH-së, kuadri ligjor që rregullon funksionimin e pikave kufitare dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve në të ka njohur ndryshime. Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufinjve dhe Plani i saj i Veprimit, ligji “Për policinë e shtetit” dhe riorganizimi strukturor i policisë kufitare, ndonëse në fazat e para të zbatimit të tij, përbëjnë një bazë ligjore për menaxhimin më të mirë të kufijve dhe respektimin e të drejtave të shtetasve në pikat e kalim kufirit.

Në disa pika kufitare të vëzhguara nga KShH-ja, u konstatua se personat e kthyer shoqëroheshin në pikat e kalim kufirit shqiptar me dokumenta në gjuhë të huaj dhe pa asnjë njoftim paraprak për të deportuarit. Kjo praktikë vjen në kundërshtim me rregullat e ripranimit dhe të transferimit të tyre. Mungesa e hartimit dhe e nënshkrimit të protokolleve për zbatimin e Marrëveshjeve të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë me vendet fqinj për ripranimin e personave me qëndrim të paligjshëm vazhdoi të ishte problem.

Në përgjithësi, në të gjitha pikat kufitare të vëzhguara nga KShH sistemi TIMS funksiononte normalisht dhe nuk paraqiste probleme. Infrastruktura kishte pësuar përmirësime në disa prej pikave kufitare të vëzhguara. Megjithatë, nevoja për përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës është një çështje me rëndësi pothuajse në të gjitha pikat kufitare. KShH-ja gjykon se përmirësimi i infrastrukturës do të garantonte respektimin më të mirë të të drejtave të njeriut në këto pika kufitare.

Një shqetësim i evidentuar pothuajse në të gjitha pikat kufitare të vëzhguara nga KShH ishte mungesa e pajisjeve logjistike dhe teknike të nevojshme për një funksionim sipas standarteve ndërkombëtare të këtyre pikave. Lëvizja dhe transporti i personave të kthyer ishte problem shqetësues në të gjitha pikat kufitare të vëzhguara. Mungesa e mjeteve të transportit dhe limiti shumë i kufizuar i karburantit e bënte akoma dhe më të vështirë përmirësimin e detyrave nga punonjësit e policisë së pikave kufitare si dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar. Nga kontaktet me personat e kthyer dhe me personelin, vëzhguesit e KShH-së mësuan se personave të kthyer nuk mund t'i ofrohej ushqim. Nevojat për ushqim të tyre plotësoheshin privatisht nga personeli.

KShH-ja vlerëson progresin e bërë për plotësimin e pjesës më të madhe të pikave kufitare të vëzhguara me personel femër. KShH-ja vlerëson përpjekjet e bëra për përmirësimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të policisë kufitare. Sipas punonjësve të kontaktuar, rezultoi se ishin organizuar disa trajnime për administratën e pikave kufitare. Megjithatë, KShH-ja vlerëson se personeli ka ende nevojë për rritjen e profesionalizmit dhe njohjen më të mirë të legjislacionit në fushë. Kjo nevojë është më e theksuar për stafit e emëruar kohët e fundit në detyrë.

Një shqetësim i përsëritur disa herë nga KShH bazuar në vëzhgimet e realizuara është mosndarja e fluksit potencialisht të mundshëm „trafikant-viktimë“ dhe kryerja e intervistës në të njëjtin ambient ku janë të gjithë të deportuarit. Në pikat e vazhguara, KShH-ja konstatoi mungesën e ambienteve të ndërtuara sipas kërkesës së ligjit për të deportuarit me precedentë penalë. KShH-ja vëren mungesën e psikologut në momentin e intervistimit të femrave të trafikuar dhe të miturve.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Member of International Helsinki Federation for Human Rights*

KShH-ja vlerëson përpjekjet e institucioneve shtetërore përgjegjëse dhe të donatorëve të ndryshëm të cilët kontribuojnë në përmirësimin e infrastrukturës dhe të ambienteve të pikave kufitare në Shqipëri. KShH-ja vlerëson se përmirësimi i kushteve fizike të pikave kufitare dhe i infrastrukturës së tyre është një çështje me rëndësi e cila kërkon marrjen e masave konkrete dhe të menjëhershme.

Disa çështje lidhur me median

Viti 2007 ka shënuar disa ngjarje të cilat kanë ndikuar në lirinë e medias dhe të shtypit në përgjithësi. Organe të caktuara shtetërore kanë ndërmarrë vendime të nxituara dhe kritike ndaj medias dhe shtypit të lirë. Drejtues të lartë të administratës shtetërore kanë bërë deklarata publike që akuzojnë median për lidhjet e saj me veprimtari të paligjshme. Këto qëndrime të qeverisë ndaj medias jo vetëm bie ndesh me parimin e prezumimit të pafajësisë por përbëjnë edhe privim ndaj saj. Kjo situatë ka shkaktuar reagime publike të përfaqësuesve të ndryshëm të medias, të shoqatave të gazetarëve dhe të disa aktorëve të shoqërisë civile. Në këtë këndvështrim, KShH duke vlerësuar kontributin e çmuar të medias në përmbushjen e misionit të saj për të informuar publikun e gjerë dhe për të qenë oponente konstruktive ndaj veprimtarisë shtetërore, me datë 12 prill 2007 ka reaguar publikisht për mbrojtjen e lirisë së shtypit dhe të fjalës së lirë si edhe për tolerancën që duhet të tregojë qeveria dhe funksionarët publik ndaj medias dhe shtypit të lirë.

Një tjetër ngjarje me rëndësi që ka tërhequr vëmendjen ka qënë vendimi i KKRT për heqjen e antenave nga pika e “Taraboshit” të antenave të dy televizioneve që mundësonin përhapjen e sinjalit të tyre në territorin e Shkodrës. Marrja e këtij vendimi të nxituar dhe të pakonsultuar paraprakisht është justifikuar me nevojën për zbatimin e ligjit, kur mosrregullimi i kësaj çështjeje nuk ka ndodhur për fajin e televizioneve ndaj të cilëve është marrë ky vendim. Ky vendim ka krijuar përshtypjen e qëndrimeve selektive duke rënë ndesh me parimin e mbrojtjes së mediave të lira dhe si pasojë, parimit të informimit të pandërprerë dhe objektiv të publikut të gjerë³. Një tjetër sulm selektiv me synime politike nga qeveria kundër medias së lirë dhe lirisë së shtypit ishte vendosja e një gjobe të konsiderueshme dhe jo transparente ndaj Televizion Top Channel. Edhe në këtë rast, në datë 15 korrik 2007, KShH ka reaguar me anë të një deklaratë publike.

Lidhur me reformën ligjore, ende nuk ka një version përfundimtar të ligjit “Për shtypin”. Gjatë këtij viti është përgatitur një projekt i cili ende nuk është miratuar. Ka gjithashtu disa pretendime të bazuara se administrata publike nuk ka zbatuar në mënyrë korrekte ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”.

³ Shih deklaratën e KShH “Vendim i nxituar me pasoja të dëmshme” datë 9 Maj 2007.